

# # 4 INFOGRAFIK

për diskriminimin në bazë gjinore në vendin e punës gjatë periudhës nëntor 2020-janar 2021






Financuar nga  
Bashkimi Evropian



Bashkëfinancuar nga  
Agjencia Suedeze për  
Bashkëpunim Ndërkombëtar




Sweden  
Sverige

- 
- 
- 
- A E D I S E:**
  - Nënat e fëmijëve deri në moshën 1 vjeçare nuk lejohen të punojnë gjatë natës dhe jashtë orarit të punës?
  - Nënat e fëmijëve nga 1 deri në 3 vjeç nuk lejohen të punojnë gjatë natës dhe jashtë orarit të punës, pa pëlqimin e tyre me shkrim?
  - Gratë shtatzëna dhe nënat e fëmijëve deri në 3 vjeç gëzojnë mbrojtje të veçantë me Ligjin për marrëdhënie pune?

## GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE KOMITETI I HELSINKIT:

- 
- 
- 2 regjistroi dy raste të diskriminimit të punonjëseve femra, në bazë të seksit, gjinisë dhe statusit personal;
  - 2 siguroi ndihmë juridike falas për dy punonjëse femra, lidhur me: punë gjatë natës dhe punë jashtë orarit të punonjëseve, nëna të fëmijëve deri në 1 vjeç dhe nëna të fëmijëve nga 1 deri në 3 vjeç, mosvazhdim të kontratës së punës me afat të caktuar të një punëtoreje shtatzënë;
  - + procedura e filluar para Avokatit të Popullit për diskriminim në bazë të seksit dhe gjinisë përfundoi me rezultat pozitiv. Avokati i Popullit gjeti diskriminim ndaj punonjëses, të kryer nga punëdhënësi - Ministria e Punëve të Brendshme;
  - / procedura e inicuar para Inspektoratit Shtetëror të Punës për shkak të pushimit të pabazuar nga puna të një punonjëseje tekstili, e cila paraprakisht kishte paraqitur parashtresë për shkak të uljes së pagës së saj për 50%, gjatë kohës që ishte e liruar nga detyrimet e punës si nënë e fëmijës deri në moshën 10 vjeçare, përfundoi me rezultat negativ. Inspektorati i Punës kishte vërtetuar se punonjëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të skadimit të afatit, për të cilin ishte lidhur kontrata e saj e punës;
  - / procedura e nisur para Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, gjithashtu përfundoi me rezultat negativ, për shkak të zbatimit të gabueshëm të Dekretit për zgjatjen e të drejtës për pushim të lindjes.

## RAST:



Disa punonjëse nga Velesi, që kanë fëmijë deri në një vjeç, iu drejtuan Komitetit të Helsinkit, sepse punojnë jashtë orarit dhe gjatë natës, kurse disa prej tyre, që kanë fëmijë deri në tre vjeç, punojnë gjatë natës me pëlqimin me shkrim, të dhënë nën detyrim. Punonjëset, që janë nëna të fëmijëve deri në moshën trevjeçare janë në marrëdhënie pune tek punëdhënësi me kontrata punësimi të lidhura në kohë të caktuar. Ato janë shantazhuar nga punëdhënësi i tyre se nëse nuk nënshkruajnë një pëlqim me shkrim me të cilin bien dakord për të punuar jashtë orarit dhe gjatë orëve të natës, kontratat e tyre nuk do të vazhdojnë. Nga frika se mos mbeteshin pa mjete jetese gjatë pandemisë, punëtoret i kishin nënshkruar pëlqimet. Punëdhënësi e ka ditur se ato kishin frikë se mos e humbin vendin e tyre të punës dhe ka qenë në dijeni se me nënshkrimet e tyre, para Inspektoratit të Punës dhe Prokurorisë do të jetë e vështirë të dëshmohet se ato nuk janë dakord të punojnë gjatë natës dhe orë shtesë, dhe për këtë arsye e ka keqpërdorur pozicionin e tyre, në favor të vetin dhe në dëm të madh të tyre. Ai jo vetëm që i ka detyruar të punojnë në këtë mënyrë, por gjithashtu nuk ua ka paguar as punën shtesë, për çka janë vërtetuar parregullësi nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Punës, pas një parashtrese të paraqitur nga ana e Komitetit të Helsinkit.

Ligji për marrëdhënie pune parashikon mbrojtje të veçantë gjatë shtatzanisë dhe prindërimit në lidhje me punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit. Gjegjësisht, gjatë shtatzanisë ose me fëmijë deri në moshën njëvjeçare, punonjësjë nuk guxon të punojë jashtë orarit ose të punojë gjatë natës (neni 164, paragrafi 1). Një punonjëseje që ka fëmijë nga një deri në tre vjeç, mund t'i kërkohej të punojë jashtë orarit ose të punojë gjatë natës, vetëm me pëlqimin e saj paraprak me shkrim (164, paragrafi 2). Pëlqimi me shkrim nga ana e punonjëses duhet të jepet lirshëm dhe vullnetarisht, pa detyrim ose kërcënim.

Kjo mënyrë e të vepruarit të punëdhënësit, i cili në fakt i ka detyruar punonjëset të punojnë gjatë natës dhe jashtë orarit, paraqet vepër penale ndaj marrëdhënies të punës, me të cilën nuk mbrohet gruaja dhe paraqet shkelje të dispozitave për punën e natës dhe jashtë orarit, e për të cilën është paraparë gjobë në të holla ose burgim deri në një vit .



Raporto diskriminimin në bazë gjinore në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, në telefonat **02 / 3119-073** dhe **072 278-436** ose në adresën elektronike **helkom@mhc.org.mk**

Ky infografik është pjesë e projektit „Punonjëse bashkohuni!“ të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, mbështetur nga Reaktor - Hululumtim në aksion, Rrjeti i Grave të Kosovës (Kosovo Women's Network) dhe partnerët e tyre në projektin „Përparim i të drejtave të punës të grave“. Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancuar nga Agjencia Suedeze për zhvillim dhe bashkëpunim ndërkombëtar (SIDA). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Komitetit të Helsinkit dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian ose SIDA - s.



РЕАКТОР  
истражување во акција

